



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK

Rihapja e Obligacioneve

(*MATERIAL INFORMUES DHE EDUKUES PËR PUBLIKUN*)

Ministria e financave në përputhje me **Udhëzimi nr.31, datë 26.12.2013; Ligji nr.9665 datë 18.12.2006** ka të drejtë që të bëjë rihapje.

Procedura e zhvillimit të ankandit të rihapur është e njëjtë me procedurën e ankandëve të obligacioneve, dhe individët marrin pjesë në ankandet e rihapura në të njëjtën mënyrë si në ankandet normale të obligacioneve.

Në ankandet e rihapura investitorët përfitojnë të njëjtin kupon me ankandin fillestar, por çmimi i blerjes së obligacioneve në ankandet e rihapura përcaktohet nga norma e interesit që do të dalë nga ankandi i rihapur.

Norma e interesit në ankandin e rihapur mund të jetë:

- E njëjtë me ankandin fillestar
- Më e lartë se ankandi fillestar
- Më e ulët se ankandi fillestar

Formulat e përlllogaritjes së çmimit të pastër dhe çmimit bruto në ankandet e rihapura janë:

$$\text{Interesi i akumuluar} = \frac{100 * I^0 * d1}{360}$$
$$\text{Çmimi pastër} = \frac{C1 * d1}{(1 + Y1 * d1)} + \frac{C2 * d2}{(1 + Y1 * d1) * (1 + Y2 * d2)} + \dots + \frac{Cn * dn + M}{(1 + Y1 * d1) * (1 + Y2 * d2) * \dots * (1 + Yn * dn)}$$

- **C** Kuponi
- **d** Raporti i ditëve të periudhës së pagesës së kuponit me 360 ditë (baza 30/360)
- **n** Numri i pagesave të kuponit
- **Y** Discount margin + normën spot 12-mujore
- **M** Vlera e maturimit të obligacionit (Par value)

Shembull: Në vijim paraqiten 3 raste hipotetike:

Rasti 1: Norma e interesit të ankandit të rihapur e njëjtë me normën e interesit të ankandit fillestar.

Rasti 2: Norma e interesit të ankandit të rihapur më e vogël se norma e interesit të ankandit fillestar.

Rasti 3: Norma e interesit të ankandit të rihapur më e madhe se norma e interesit të ankandit fillestar.

Rihapet ankandi 5-vjeçar me kupon fiks (ankandi fillestar më datë 01.01.2016 ndërsa rihapja më datë 01.04.2016).

Rasti	Dt.Emetimi	Dt.Maturimi	Shuma	I^0	I^1	I.akumuluar	Çmimi i pastër	
1	01.04.2016	01.01.2021	100	5%	5%	1,25	100	<i>Par value</i>
2	01.04.2016	01.01.2021	100	5%	4%	1,25	104.28	<i>Premium</i>
3	01.04.2016	01.01.2021	100	5%	6%	1,25	95.91	<i>Discount</i>

Në rastin e parë pjesëmarrësit do të paguajnë 100,00 lekë në ankandin e rihapjes për të blerë 100,00 lekë obligacione të cilat janë emetuar 3 muaj më parë.

Në rastin e dytë pjesëmarrësit do të paguajnë 104,28 lekë në ankandin e rihapjes për të blerë 100,00 lekë obligacione të cilat janë emetuar 3 muaj më parë.

Në rastin e tretë pjesëmarrësit do të paguajnë 95,91 lekë në ankandin e rihapjes për të blerë 100,00 lekë obligacione të cilat janë emetuar 3 muaj më parë.

Për çdo të ardhur nga investimi në titujt qeveritarë investitorët duhet të paguajnë tatimin mbi fitimin, i cili aktualisht është 15%.